



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1252/Prot  
5

Tiranë, më 05/11 /2020

VENDIM

Nr. 48, datë 05.11 .2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1202 Prot., datë 06.10.2020, si dhe Formularin e Ankesës nr. 1252 Prot., datë 16.10.2020, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Ministria e Financave dhe Ekonomisë" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit nëpërmjet shkresës së datës 09.10.2020, depozituar në adresën elektronike të koordinatorit për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik [jonida.kaza@financa.gov.al](mailto:jonida.kaza@financa.gov.al), ka kërkuar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni, si më poshtë:

- *Kopje të Vendimit Nr. 60, të ministrisë për fillimin e inspektimit financiar publik, dt. 02.06.2020, së bashku me një kopje të vendimit të ndryshuar;*
- *Datën e vendimmarrjes së një inspektimi, përfundimtare lidhur me inspektimet e kryera gjatë vitit 2019.*

Në mungesë të një përgjigje nga ana e Autoritetit Publik, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur fillimisht ankimin nr. 1202 Prot., datë 06.10.2020, si dhe ankimin nr. 1252 Prot., datë 16.10.2020, pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.



Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesave, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesat përmbushin kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit".

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Zyra e Komisionerit, komunikoi me Autoritetin Publik duke i kërkuar vlerësimin e dhënies së informacionit.

Koordinatorja e së drejtës për informim ka sqaruar për Zyrën e Komisionerit se nuk e ka administruar kërkesën për informim të z.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit ka këshilluar ankuesin të ridërgojë kërkesën për informim pranë Autoritetit Publik.

Në vijim, nëpërmjet e-mail-it të datës 09.10.2020 ankuesi ka ridërguar një kërkesë për informacion të dërguar edhe më parë (më 3 tetor 2020), në adresën e ish-koordinatores për të drejtën e informimit. Në përgjigje të kërkesës së sipërcituar, Autoriteti Publik nëpërmjet e-mailit të datës 13.10.2020 ka kthyer përgjigje duke sqaruar se inspektimi është në proces vendimmarrje nga Autoritetet respektive ligjore, në referencë të ligjit 112/2015 "Për inspektimin financiar publik" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Në përfundim të procedurës në faqen zyrtare të Ministrisë do të publikohet Raporti përmbledhës.

Ankuesi ka vijuar komunikimin me e-mailin e datës 13.10.2020, në të cilin ka parashtruar se informacioni i vënë në dispozicion nuk tregon kohën (datën) se kur është marrë vendimi përfundimtar, lidhur me inspektimet e kryera si dhe datën e vendimmarrjes përfundimtare të inspektimeve të kryera.

Në përgjigje të e-mailit të sipërcituar, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje me anë të shkresës nr. 16832 Prot, datë 21.10.2020, drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për dijeni kërkuarit, duke argumentuar se inspektimi është në proces vendimmarrje nga Autoritetet respektive ligjore, në referencë të ligjit 112/2015 "Për inspektimin financiar publik" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Në përfundim të procedurës raporti përmbledhës do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Gjithashtu, përmes e-mailit të datës 28.10.2020, ka sqaruar se informacioni disponohet në formatin që i është vënë në dispozicion kërkuarit, përmes një linku, për një kërkesë të mëparshme të dërguar prej tij.

Ankuesi, me e-mailin e datës 23.10.2020, si dhe me e-mailin e datës 29.10.2020 ka vijuar ankimin pranë Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar detyrimin e Autoritetit Publik për të vënë në dispozicion informacionin e kërkuar, konkretisht: "*Kopje të Vendimit Nr. 60, të ministrisë për fillimin e inspektimit financiar publik, dt. 02.06.2020, së bashku me një kopje të vendimit të ndryshuar*", si dhe datën e vendimmarrjes së një inspektimi, përfundimtare lidhur me inspektimet e kryera gjatë vitit 2019.



Në vijim, me Urdhri nr. 159, datë 26.10.2020, Komisioneri vendosi kryerjen e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke filluar nga data 27.10.2020, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që lidhen me çështjen objekt inspektimi.

Pranë Autoritetit Publik u depozitua urdhri i inspektimit administrativ dhe u protokollua me nr. 20196 Prot., datë 27.10.2020.

Gjatë inspektimit, Koordinatorja sqaroi se kërkesa për informim, dërguar nga z.

, i është përcjellë për trajtim me e-mailin e datës 09.10.2020 Drejtorisë së Inspektimit Financiar. Kjo e fundit, me anë të shkresës nr. 16832 Prot, datë 21.10.2020, drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për dijeni kërkuarit, referuar kuadrit ligjor të inspektimit financiar publik, si dhe të së drejtës për informim, ka sqaruar se Njësia Përgjegjëse për inspektimin financiar publik, nuk ka detyrim ligjor dhënien e informacionit, pasi bazuar në nenin 15 të ligjit 112/2015 "Për inspektimin financiar publik", *"Njësia përgjegjëse për inspektimin financiar publik jep informacion për inspektimet financiare publike të kryera, kur informacioni kërkohej nga autoritetet publike, të cilëve u jepet e drejta me ligj"*, si dhe bazuar në nenin 2 të Ligjit nr. 119/2014 *"Për të Drejtën e Informimit"*, në të cilin përcaktohet qartë përkufizimi i Autoritetit Publik, kërkuari nuk është Autoritet Publik. Për rrjedhojë, Njësia Përgjegjëse për inspektimin financiar publik, nuk ka detyrim ligjor dhënien e informacionit, sikurse kërkuar nga z.

Gjithashtu koordinatorja sqaroi se: bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 119/2014 *"Për të Drejtën e Informimit"*, *"E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: .....ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;"*.

Në vijim të argumenteve ligjorë, koordinatorja e së drejtës për informim sqaroi se referuar nenit 21, të ligjit nr. 112/2015 *"Inspektimi financiar publik kryhet në bazë të akteve nënligjore të miratuara nga Ministri i Financave, sipas pikës 2, të nenit 9, të këtij ligji. Rregullat dhe procedurat për kryerjen e inspektimit financiar publik miratohen nga Ministri i Financave. Ato përmbajnë të gjitha proceset që kryhen gjatë një shërbimi inspektimi, pas marrjes së vendimit për fillimin e tij, deri në zbatimin e masave të kërkuara nga Ministri i Financave, sipas pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji"*, do të bëhet publikimi në faqen zyrtare, i rezultateve të inspektimit, ku përfshihet numri dhe datë vendimi, objekt i inspektimit, subjektet, shkeljet e konstatuara etj. Informacioni do të jetë i aksesueshëm nga publiku.

Pas administrimit të argumenteve të parashtruara nga përfaqësuesi i Autoritetit Publik, grupi i inspektimit konstatoi se Autoriteti Publik administron informacionin/dokumentacionin e kërkuar dhe si rrjedhojë duhet ta kishte vënë në dispozicion të kërkuarit.



Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: *“Njësia përgjegjëse për inspektimin financiar publik jep informacion për inspektimet financiare publike të kryera, kur informacioni kërkohet nga autoritetet publike, të cilëve u jepet e drejta me ligj”*, Zyra e Komisionerit vlerëson se, përcaktimi i ligjit material nuk konfliktin me ligjin për të drejtën e informimit. Neni 15 i ligjit 112/2015 “Për inspektimin financiar publik”, rregullon marrëdhënien ndërmjet njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik dhe autoriteteve publike, kur prej tyre kërkohet informacion lidhur me inspektimet financiare publike të kryera. Dispozita e cituar nuk rregullon kufizimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit. Në rastin konkret, informacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik dhe publikohet në mënyrë proaktive nga vetë Autoriteti Publik.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: *“...referuar gërmës “ç”, të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, e drejta e informimit në këtë rast kufizohet, pasi dhënia e informacionit shkakton një dëm ndaj interesit të mbarëvajtjes së procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike”*, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Autoritetit Publik nuk ka arsyetuar në lidhje me vlerësimin e parimit të proporcionalitetit, si dhe dëmin e qartë dhe të rëndë në interesin e mbarëvajtjes së procedurave të inspektimit apo auditimit financiar që mund të vinte si pasojë e dhënies së informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar.

Pika 2 e nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon se: *“e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë”*.

Ky parashikim nuk mund të aplikohet apriori nga ana e Autoritetit Publik, por duhet të analizohet dhe të argumentohet nëse nxjerrja e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar do të shkaktoje një dëm serioz, të qartë dhe të rëndë për mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit. Autoriteti Publik ka detyrimin në çdo rast të provojë dëmin e qenësishëm dhe të vlerësojë proporcionalitetin e këtij dëmi në raport me të drejtën e publikut për të patur dijeni.

Lidhur me qëndrimin e Autoritetit Publik, në përgjigjen e kthyer për kërkuesin, ku citohet se: *“.... informacioni është vënë në dispozicion të kërkuesit, në formatin që disponohet”*, Zyra e Komisionerit vlerëson se, argumenti i dhënë nuk është i bazuar në ligj. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuesit: *a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta; b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet*.



Për sa më sipër, Autoriteti Publik detyrohet të vendosë në dispozicion të kërkuarit informacionin/ dokumentacionin e kërkuar sipas objektit të kërkesës.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit *"informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

Komisioneri vlerëson se, për sa kohë Autoriteti Publik disponon informacionin /dokumentacionit e kërkuar, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të kërkuarit.

Autoriteti Publik, duhet të vendos në dispozicion të kërkuarit informacionin e kërkuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim"*.

Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 të ligjit për të drejtën e informimit, parashikohet se mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për atë që nuk përbëjnë veprë penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

Bazuar në sa më sipër, mosveprimi në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe detyrimin sipas këtij vendimi, passjell vendosjen e penaliteteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 18, ndaj personave përgjegjës.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. \_\_\_\_\_ ndaj Autoritetit Publik/Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komisioneri vlerëson se ankesat janë të bazuara në ligj dhe si të tillë ato duhen pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1202 Prot., datë 06.10.2020, dhe ankesës nr. 1252 Prot., datë 16.10.2020 të z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 09.10.2020, brenda datës 12. 11.2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 05. 11.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

